

## Shtojca 2

# Operatorët e Autorizuar Ekonomik (OAE)

## Pyetësor për vetëvlerësim

Udhëzime për subjektet e autorizuara ekonomike

Është e rekomanduar për t'i lexuar udhëzimet e Komisionit Evropian për subjektet e autorizuara ekonomike TAXUD/B2/047/2011, Rev.5., para se të aplikoni për statusin

### OAE UDHËZUSI

<b>0.1.</b>	Subjekti i autorizuar ekonomik (Udhëzimet janë në dispozicion në web faqen- Dogana e Republikës së Kosovës.
-------------	---

<b>0.2.</b>	Cilin departament, duke përfshirë administratën e keni përfshirë në procedurën e përgatitjes së ndërmarrjes tuaj për aplikim, për statusin e subjektit të autorizuar ekonomik?
-------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.</b>	<b>Të dhënat për ndërmarrjen</b>
<b>1.1.</b>	<b>Të dhënat e përgjithshme për ndërmarrjen</b>

<b>1.1.1.</b>	<p>Shkruajeni emrin, adresën, datën e krijimit dhe formën ligjore të organizimit të ndërmarrjes e cila aplikon. Ju lutemi shkruajeni linkun në web faqen e kompanisë suaj, nëse ka. Nëse kompania juaj është pjesë e një grupi, ju lutem tregoni subjektin tjetër në grup:</p> <p>a) Tashmë e ka certifikatën OAE; ose</p> <p>b) Ka aplikuar për statusin e OAE dhe aktualisht është në procesin e kontrollit të mëvonshëm të OAE, që e kryen Autoriteti i Doganave.</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.1.2.</b>	<p>Ju lutem jepni detajet e mëposhtme (nëse zbatohen me formën ligjore të kompanisë tuaj):</p> <p>a) Detajet e aksionarëve kryesor, duke përfshirë përqindjen e aksioneve të tyre;</p> <p>b) Detajet e anëtarëve të menaxhmentit dhe/ ose drejtorët;</p> <p>c) Detajet e Bordit këshillëdhënës, nëse ka dhe Bordit të drejtorëve.</p> <p>Detajet duhet të përfshijnë emrin e plotë dhe adresën, datën e lindjes dhe numrin identifikimit (p.sh. numri i kartës së identitetit ose numri i sigurimit social).</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.1.3.</b>	Ju lutem, shkruajeni emrin e personit në administratë që e ka paraqitur kërkesën, e që është kompetent për çështje doganore. Detajet duhet të përfshijnë emrin e plotë, adresën, datën e lindjes dhe numrin e identifikimit (p.sh. numri i kartës së identitetit ose numri i sigurimit social).
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.1.4.</b>	Ju lutem, përshkruani shkurtimisht veprimtarinë tregtare/ biznesin tuaj dhe cekeni pozitën tuaj në zinxhirin e furnizimit ndërkombëtar (prodhues, eksportues, transportues mallrash, mbajtësi i depos doganore, agjent doganor, transportues, importuesi, operator i depos së konsolidimit, operator i terminalit, etj.).
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>1.1.5.</b>	Ju lutem tregoni vendet, adresat, emrat, numrat e telefonit dhe e-mail adresat e njerëzve, për t'i kontaktuar dhe shkurtimisht përshkruani aktivitetet e kryera në vendet e mëposhtme (duke përfshirë shtetet e tjera): a) Lokacionet individuale të kompanisë tuaj si person juridik (ju lutemi shënoni numrin e përafërt të punonjësve në çdo departament); dhe b) Lokacionet ku një palë e tretë kryen aktivitete të veçanta për kompaninë tuaj.
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>1.1.6.</b>	A jeni në marrëdhënie të shitblerjes me ndërmarrjet e ndërlidhura? Po/ jo
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>1.1.7.</b>	Përshkruani strukturën e brendshme organizative të ndërmarrjes suaj dhe detyrat/ përgjegjësitë e secilit departament.
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>1.1.8.</b>	Ju lutem, shënojin emrat e menaxhmentit të lartë: (drejtori, udhëheqësi i departamentit, udhëheqësi i kontabilitetit, udhëheqësi i departamentit doganor, etj.), në ndërmarrje dhe shkurtimisht përshkruajini rregullat e zëvendësimit.
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>1.1.9.</b>	Sa punëtor i ka ndërmarrja juaj?
---------------	----------------------------------

**Përgjigje:**

<b>1.1.10.</b>	Ju lutemi, shkruajini emrat dhe pozitat e personave në ndërmarrjen tuaj, që kanë njohuri të veçanta profesionale në lëmin e Doganës. b) Ju lutemi që shkurtimisht ta përshkruani nivelin e njohurive të personave të cekur, duke pasur parasysh në lidhje me përdorimin e teknologjisë informative në procedurat doganore e tregtare dhe përgjithësisht në fushën e tregtisë.
----------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.1.11.</b>	<p>Me këtë pajtohem për publikimin e të dhënave nga certifikata OAE në listën e operatorëve të autorizuar ekonomik të përmendur në nenin 19 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ për Operatorët e Autorizuar Ekonomik. Po/ jo</p> <p>Nëse po Nënshkrimi..... statusi i nënshkruesit ..... Nënshkrimi..... statusi i nënshkruesit..... (Pyetësoin e plotësuar duhet ta nënshkruajë drejtori/partneri me të drejtën e udhëheqjes/ tregtari i vetëm, varësisht nga rasti, por në këtë rast rekomandohet, që pëlqimin ta japë nënshkruesi i autorizuar)</p> <p>Data:.....</p>
----------------	--

<b>1.1.12.</b>	<p>Me këtë pajtohem për të bërë shkëmbimin e informatave në autorizimin e AOE, me qëllim të sigurimit të implementimit të marrëveshjeve ndërkombëtare me vendet e treta mbi njohjen e përbashkëta të statusit të operatorit të autorizuar ekonomik dhe masave lidhur me sigurinë: Po/ Jo</p> <p>Nëse po Nënshkrimi..... Kapaciteti i Nënshkruesit .....</p> <p>(Pyetësoin e plotësuar duhet ta nënshkruajë drejtori/ partneri me të drejtën e udhëheqjes/ tregtari i vetëm, varësisht nga rasti, por në këtë rast rekomandohet që pëlqimin ta japë nënshkruesi i autorizuar).</p> <p>Data:.....</p>
----------------	---

<b>1.1.13.</b>	<p>Në rast se pajtoheni për njohjen reciproke në rubrikën 1.1.12, ju lutemi t'i shënoni këto të dhëna:</p> <p>Titulli:..... Rruga ..... dhe numri:..... Numri ..... post ..... dhe ..... qyteti .....</p> <p>Duhet t'i përdorni vetëm shkronjat latine ( Times New Roman).</p>
----------------	--

<b>1.2.</b>	<b>Vëllimi i punëve</b>
-------------	-------------------------

<b>1.2.1.</b>	a) Shënojeni qarkullimin vjetor për tri raportet e përfunduara vjetore. Nëse bëhet fjalë për
---------------	--

	<p>ndërmarrje të re, cekeni NR.</p> <p>b) Specifikojeni neto fitimin vjetor apo humbjet për tri raportet e përfunduara vjetore. Nëse bëhet fjalë për ndërmarrje të re, cekeni NR.</p>
--	---

**Përgjigje:**

<b>1.2.2.</b>	Nëse i përdorni hapësirat e depove që nuk janë në pronësinë tuaj, ju lutemi shënojeni personin nga i cili e keni marrë hapësirën me qira.
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>1.2.3.</b>	<p>Për secilin kapitull në vazhdim shënojeni vlerësimin e numrit dhe të vlerave të deklaratave të kryera për secilin nga tre vjetët e fundit. Nëse bëhet fjalë për ndërmarrje të re, shënojeni NR.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Import</li> <li>- Eksport/ri-eksport</li> <li>- Transit</li> </ul>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.2.4.</b>	<p>Për secilin kapitull në vazhdim shënojeni vlerësimin e shumës së përgjithshme të paguar për secilin nga tre vjetët e fundit. Nëse bëhet fjalë për ndërmarrje të re, shënojeni NR.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tarifat doganore</li> <li>- Taksat e akcizës</li> <li>- TVSH gjatë importit</li> </ul>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.2.5.</b>	<p>a) A i keni paraparë ndryshimet strukturore në ndërmarrjen tuaj në dy vjetët e ardhshme? Po/jo. Nëse po, përshkruani shkurtimisht ndryshimet.</p> <p>b) A parashikoni ndryshime të mëdha në zinxhirin e furnizimit për ndërmarrjen tuaj në dy vjetët e fundit? Po/jo. Nëse po, përshkruani shkurtimisht ndryshimet.</p>
---------------	--

**Përgjigje :**

<b>1.3.</b>	<b>Të dhënat doganore dhe statistika</b>
<b>1.3.1.</b>	<p>Ju lutemi, përgjigjuni në këto pyetje:</p> <p>a) Ai kryeni formalitetet doganore në emrin tuaj dhe për llogarinë tuaj?</p> <p>b) A ju përfaqëson dikush në formalitetet doganore? Nëse po, kush dhe si (direkt apo indirekt)? Ju lutemi, cekini emrin, adresën dhe numrin e përfaqësuesit EORI.</p> <p>c) Ai përfaqësoni ju personat e tjerë në formalitetet doganore? Nëse po, kë dhe si (direkt apo indirekt)? (Cekini emrat e ndërmarrjeve më të rëndësishme).</p>

**Përgjigje:**

<b>1.3.2.</b>	<p>a) Kush dhe si vendos për klasifikimin e mallrave në tarifën doganore?</p> <p>b) Çfarë masash për sigurimin e cilësisë ndërmerrni në mënyrë që të sigurohet klasifikimi i saktë në tarifën doganore (p.sh. kontrolli, kontrolli i vërtetësisë, udhëzime të brendshme, trajnimin e rregullt)?</p> <p>c) A mbani shënime për këto masa për sigurimin e cilësisë?</p> <p>d) A e përcillni rregullisht efektivitetin e masave për sigurimin e cilësisë?</p> <p>e) Cilat mjete i përdorni për klasifikimin tarifor (p.sh. baza e të dhënave të përhershme për mallrat)?</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>1.3.3.</b>	<p>a) Kush dhe si e përcakton vlerën doganore?</p> <p>b) Cilat masa i merrni për sigurimin e cilësisë me qëllim të përcaktimit të saktë të vlerës doganore (p.sh. kontrolli, kontrolli i vërtetësisë, udhëzime të brendshme, trajnimin e rregullt, etj.)?</p> <p>c) A e përcillni rregullisht efektivitetin e masave për sigurimin e cilësisë?</p> <p>d) A mbani shënime për këto masa për sigurimin e cilësisë?</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.3.4.</b>	<p>a) Jepini një pasqyrë të origjinës preferenciale apo jo preferenciale të mallrave të importuara.</p> <p>b) Cilat aktivitete të brendshme i keni vendosur për të verifikuar, nëse në deklaratë është cekur vendi i saktë i origjinës për mallrat e importuara?</p> <p>c) Përshkruani mënyrën e lëshimit të vërtetimit të origjinës preferenciale dhe certifikatave të origjinës për eksport.</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>1.3.5.</b>	<p>A keni të bëni me mallra që i nënshtrohen taksave anti-damping apo atyre kompensuese? Po/Jo</p> <p>Nëse po, cekini detajet e prodhuesit/ve apo vendeve jashtë BE-së, mallrat e të cilave i nënshtrohen taksave të cekura më lartë.</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>2.</b>	<b>Evidenca e harmonizimit me rregullat</b>
<b>2.1.</b>	<p>a) A janë zbuluar në tre vjetët e fundit në ndërmarrjen tuaj shkelje të dispozitave doganore apo i ka zbuluar organi doganor? Nëse bëhet fjalë për ndërmarrje të re, cekeni NR. Nëse po, përshkruani shkurtimisht shkeljen.</p> <p>b) Si i keni informuar autoritetet kompetente kombëtare për shkeljen dhe cilat masa janë marrë për sigurimin e cilësisë për të shmangur shkeljet e tilla në të ardhmen?</p> <p>A mbani shënime për këto masa për sigurimin e cilësisë?</p>

**Përgjigje:**

<b>2.2.</b>	<p>A janë refuzuar disa kërkesa për leje/ certifikatë apo lejet ekzistuese përkohësisht apo përgjithmonë janë anuluar për shkak të shkeljeve të dispozitave doganore në tre vjetët e fundit?</p> <p>Po/jo. Nëse bëhet fjalë për ndërmarrje të re, ckeni NR.</p> <p>Nëse po, sa kanë qenë dhe cilat kanë qenë arsyet?</p>
-------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.</b>	<b>Sistemi i kontabilitetit dhe i logjistikës</b>
<b>3.1</b>	<b>Evidenca e ngjarjeve</b>

<b>3.1.1</b>	<p>A mundëson sistemi juaj i kontabilitetit evidencë të plotë të ngjarjeve të aktiviteteve tuaja doganore apo qarkullimit të mallrave apo regjistrimi i rëndësishëm për tatimim ?</p> <p>Nëse po, ju lutemi përshkruani elementet kryesore të kësaj evidence të ngjarjeve.</p>
--------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.2.</b>	<b>Sistemi i kontabilitetit</b>
-------------	---------------------------------

<b>3.2.1.</b>	<p>Çfarë sistemi të informacionit (pajisjet kompjuterike/ programet kompjuterike) i përdorni në biznesin e juaj në përgjithësi dhe në veçanti për çështje doganore?</p> <p>Cekini të dhënat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndarja e funksioneve ndërmjet zhvillimit, testimit dhe punës;</li> <li>- ndarja e funksioneve ndërmjet përdoruesve;</li> <li>- kontrolleve të qasjes (kush është në raport me kë); dhe</li> <li>- rrjedhshmëria ndërmjet sistemit afarist dhe sistemit të deklarimit.</li> </ul>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.2.2.</b>	<p>A mundet në kuadër të sistemeve tuaja të kontabilitetit të dallohet malli nga Unioni dhe malli që nuk ka status të Unionit? Po/jo</p> <p>Nëse po, cekini detajet:</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.2.3.</b>	<p>a) Ku i kryeni aktivitetet tuaja kompjuterike?</p> <p>b) A janë të ndara aplikacionet kompjuterike? Nëse po, cila firmë është përgjegjëse për aplikacionet e ndara dhe si e menaxhoni kontrollin e qasjes së aplikacioneve të ndara?</p>
---------------	---

Përgjigje:

<b>3.3.</b>	<b>Sistemi i kontrollit të brendshëm</b>
-------------	--

<b>3.3.1.</b>	<p>A keni udhëzime të brendshme për sistemin e kontrollit të brendshëm në Departamentin e kontabilitetit, Departamentin e prokurimit, Departamentin e shitjes, Departamentin doganor, menaxhimit dhe logjistikës lidhur me prodhimin, materialet dhe mallrat? Po/jo.</p> <p>Nëse po, ju lutemi përshkruani shkurtimisht ato dhe cekeni se si azhurnohen .</p> <p>Shembuj: veprime të tilla si udhëzimet e punës; trajnimi i punonjësve; udhëzime për kontrollin e mangësive dhe mekanizmi për korrigjim.</p>
---------------	--

Përgjigje:

<b>3.3.2.</b>	<p>A u janë nënshtruar procedurat tuaja të kontrollit të brendshëm ndonjëherë auditimit të brendshëm/ jashtëm? Po/jo.</p> <p>A janë përfshirë këtu rishikimi i procedurave tuaja të zakonshme doganore? Po/jo.</p> <p>Nëse po, ju lutemi sigurojeni kopjen e raportit të fundit të auditimit.</p>
---------------	---

Përgjigje:

<b>3.3.3.</b>	<p>Shkurtimisht përshkruani procedura e juaja për verifikimin e skedarëve kompjuterikë (të dhënat e përhershme apo skedarët amë). Sipas mendimit tuaj, në çfarë mënyre merren ato procedura për këto rreziqe:</p> <p>a) Regjistrim jo i drejtë dhe/ apo jo i plotë i transaksioneve në sistemin e kontabilitetit</p> <p>b) Përdorimi jo i saktë i të dhënave të përhershme apo të vjetruara, sikurse numri i artikullit dhe kodi tarifor.</p> <p>c) Kontrolli joadekuat i procedurës në ndërmarrje në kuadër të afarizmit të aplikantit.</p>
---------------	--

Përgjigje:

<b>3.4.</b>	<b>Qarkullimi i mallrave</b>
-------------	------------------------------

<b>3.4.1.</b>	<p>Përshkruani shkurtimisht procedurën e regjistrimit (fizikisht dhe në regjistër), për qarkullimin e materialeve nga marrja e materialeve, magazinimit, prodhimit dhe dërgimit. Kush e ruan evidencën dhe ku ruhet ajo?</p>
---------------	--

Përgjigje:

<b>3.4.2.</b>	<p>Përshkruani shkurtimisht procedurat që kryhen me qëllim të verifikimit të gjendjes së stoqeve, duke përfshirë shpeshhtësinë e këtyre verifikimeve dhe trajtimi i shmangieve të verifikuara (p.sh. inventarizimi dhe stoqet).</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>3.5.</b>	<b>Procedurat e zakonshme doganore</b>
-------------	--

<b>3.5.1</b>	<p>A keni procedura të dokumentuara për verifikimin e saktësisë së deklaratave doganore, duke përfshirë ato që në emrin tuaj i kanë dorëzuar, p.sh. përfaqësuesi doganor apo dërguesi?</p> <p>Po/jo.</p> <p>Nëse po, përshkruani shkurtimisht procedurat.</p> <p>Nëse jo, a e verifikoni saktësinë e deklaratave doganore? Po/jo. Nëse po, si?</p>
--------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.5.2.</b>	<p>a) A ka në ndërmarrjen tuaj udhëzime apo këshilla për njoftimin e organeve kompetente për parregullsitë (p.sh. dyshimi për vjedhje, thyerje apo kontrabandë që ndërlidhet me mallin doganor)?</p> <p>A janë dokumentuar këto udhëzime (p.sh. udhëzime për punë, doracakët, dokumentet e tjera bashkë me udhëzime)?</p> <p>b) A keni zbuluar gjatë vitit të kaluar ndonjë parregullsi (apo keni supozuar ekzistimin e parregullsive) dhe për to i keni njoftuar organet kompetente? Po/jo.</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.5.3.</b>	<p>A i tregtoni mallrat që u nënshtrohet licencave për tregtim, p.sh. pëlhura, produktet bujqësore? Po/jo.</p> <p>Nëse po, përshkruani shkurtimisht procedurat e juaja për lëshimin e licencës, që kanë të bëjnë me import/eksport të këtyre mallrave.</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.6.</b>	<b>Procedurat për përpilimin e kopjeve të sigurta, kthimi (back-up) i të dhënave, procedura rezervë dhe ruajtja</b>
-------------	---

<b>3.6.1.</b>	<p>Përshkruani shkurtimisht procedurat për përpilimin e kopjeve të sigurta, kthimin e të dhënave (back up), procedurën rezervë, ruajtjen dhe gjetjen e evidencës suaj afariste.</p>
---------------	---



**Përgjigje:**

<b>3.6.2.</b>	Sa gjatë ruhen të dhënat në sistemin e prodhimit dhe sa gjatë arkivohen?
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.6.3.</b>	A ka ndërmarrja plan për rrethana të paparashikuara në rastin të çrregullimit të punës në sistem/rënie e sistemit? Po/jo.
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>3.7.</b>	<b>Mbrojtja e sistemeve informatike</b>
-------------	---

<b>3.7.1.</b>	a) Shkurtimisht përshkruani veprimet që ju i ndërmerrni për t'i mbrojtur sistemet e juaja kompjuterike nga ndërhyrja e paautorizuar (firewall, antivirus, program për mbrojtjen e fjalëkalimit...) b) A e keni bërë testimin e ndërhyrjes në sistem, cilat kanë qenë rezultatet dhe a është marrë ndonjë masë korrektuese?
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>3.7.2.</b>	a) Përshkruani shkurtimisht mënyrën e dhënies së drejtës për qasje në sistemet kompjuterike. b) Kush është përgjegjës për funksionimin dhe mbrojtjen e sistemeve kompjuterike?
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>3.7.3.</b>	a) Ku gjendet serveri juaj kryesor? b) Përshkruani në detaje si mbrohet serveri juaj kryesor.
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.8.</b>	<b>Siguria e dokumenteve</b>
-------------	------------------------------

<b>3.8.1.</b>	Shkurtimisht përshkruani veprimet që i keni ndërmarrë për të mbrojtur (p.sh. të drejtat e kufizuara në qasje, krijimi i kopjeve të sigurta elektronike (bac-kup), të dhënat/dokumentet nga qasja e paautorizuar, keqpërdorimi, shkatërrimi i qëllimshëm dhe humbjet.
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.8.2.</b>	A ka pasur gjatë vitit të kaluar raste të qasjes së paautorizuar në dokumente dhe nëse po, cilat masa janë marrë që të evitohet përsëritja e qasjes së paautorizuar?
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>3.8.3.</b>	Ju lutemi përgjigjuni shkurtimisht në këto pyetje: a) Cila kategori e punëtorëve ka qasje në të dhënat për qarkullimin e mallrave dhe materialit? b) Cila kategori e punëtorëve mundet t'i ndryshojë këto të dhëna? A ka ndonjë dokument të detajuar për këto ndryshime?
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>3.8.4.</b>	Shkurtimisht përshkruani kërkesat në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes që u keni vendosur partnerëve tuaj tregtarë dhe personave të tjerë të kontaktit për të shmangur keqpërdorimin e të dhënave (p.sh. rrezikimi i zinxhirit të furnizimit me transferimin e paautorizuar të detajeve të dërgesës).
---------------	---

**Përgjigje:**

#### **4. Aftësia financiare e pagesës (solventitet)**

<b>4.1.</b>	A është ngritur procedurë në tre vjetët e fundit për shkak të paftësisë financiare për pagesë në raport me pasurinë e firmës suaj? Po/Jo. Nëse po, ju lutemi cekini detajet.
-------------	---

**Përgjigje:**

<b>4.2.</b>	A ka qenë gjendja financiare e kompanisë tuaj gjatë tri vjetëve të fundit mjaft e mirë dhe nëse kompania ka pasur fonde të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj financiare? Nëse po, ju lutem të siguroni prova të tilla si shkresat e auditorit apo raporti i auditimit, një kopje të llogarive tuaja përfundimtare (nëse raporti nuk është audituar), dëshmi nga banka ose institucioni financiar. Nëse jo, ju lutem të siguroni të gjitha detajet.
-------------	--

**Përgjigje:**

<b>4.3.</b>	Nëse firma juaj është e sapoformuar, siguroni të gjitha shkresat dhe të dhënat për gjendjen e saj financiare, p.sh. qarkullimi i fundit i parave, bilanci si dhe prognoza e fitimit dhe humbjeve që i kanë lejuar drejtorët/ partnerët/ tregtari.
-------------	---

**Përgjigje:**

<b>4.4.</b>	A ka diçka që mundet të ndikojë në aftësinë tuaj financiare të pagesave në një të ardhme të afërt? Po/jo. Nëse po, cekini detajet.
-------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.</b>	<b>Kërkesat në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes</b>
<b>5.1.</b>	<b>Vetëvlerësimi</b>
<b>5.1.1.</b>	a) A keni bërë vlerësimin e rrezikut dhe kërcënimeve për afarizmin tuaj? Po/jo.  b) A keni plan të sigurisë për secilin lokacion (nëse është e nevojshme)? Po/jo. Sa shpesh azhurnohen dhe rishikohen ato dokumente?

**Përgjigje:**

<b>5.1.2.</b>	Përshkruani shkurtimisht cilat janë rreziqet e sigurisë (brenda kompanisë ose në marrëdhëniet e saj me klientët, furnizuesit dhe ofruesit e shërbimeve të jashtme), të përcaktuara në lidhje me kriteret e sigurisë së OAE-së.
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.1.3.</b>	Si zbatohen dhe koordinohen masat e sigurisë në firmën tuaj dhe kush është përgjegjës për to?
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.1.4.</b>	Nëse keni më shumë hapësira afariste brenda firmës suaj, a është i harmonizuar zbatimi i masave të sigurisë në të gjitha ato vende? Po/jo.
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.1.5.</b>	a) A keni ndonjë udhëzim në aspektin e sigurisë? Si ia transmetoni personelit tuaj dhe njerëzve të cilët vizitojnë hapësirat afariste të firmës suaj? b) Si janë të dokumentuara (doracak, udhëzime për punë, formular informativ, etj.)?
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.1.6.</b>	a) A keni pasur ndonjë incident të sigurisë vitin e kaluar? Po/jo. Nëse po, ju lutemi përshkruani shkurtimisht incidentet dhe masat që i keni vënë për t'i evituar përsëritjen e tyre. b) A mbani evidencë për incidentet e sigurisë dhe të masave të marra? Po/jo.
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.1.7.</b>	a) A keni marrë konfirmim/ licencë në fushën e sigurisë (transporti, aviacioni civil, etj.), nga agjencitë e tjera publike apo organi kompetent? Po/jo. Nëse po, ju lutemi ta dorëzoni një kopje të certifikatës/ licencës dhe cekini detajet për hapësirat afariste/ lokacionet, që përfshihen në certifikatën/ licencën aktuale. b) Dorëzoni një listë e të gjitha normave/ licencave/ lejeve të pranuar në mënyrë të pavarur të cilat i mbani dhe përcaktoni se çfarë kontrolli/ rishikimi i nënshtrohen këto norma. c) A keni ndërmend që në momentin e dorëzimit të kërkesës për status të OEA-së, të paraqiteni apo tashmë jeni paraqitur për ndonjë certifikatë/ licencë tjetër për nevoja të sigurisë (p.sh. agjent i rregullt, dërgues i njohur, etj.)? Po/jo.
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.1.8.</b>	A ka kushte të veçanta në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes për mallin që e importoni/ eksportoni?
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.1.9.</b>	a) A i shfrytëzoni shërbimet e kompanive të sigurimit? Nëse po, cilat shërbime i shfrytëzoni? b) A e ka bërë Kompania vlerësimin e kërcënimit për firmën tuaj? Nëse po, përshkruani shkurtimisht, cilat rreziqe të sigurisë i keni identifikuar në raport me kriteret e sigurisë së OEA-së.
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.1.10.</b>	A ju imponojnë klientët apo shoqëritë e sigurimit kushtet e sigurisë dhe të mbrojtjes? Po/jo.  Nëse po, cekni detajet.
----------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.2.</b>	<b>Qasja në objektet afariste</b>
-------------	-----------------------------------

<b>5.2.1.</b>	a) Përshkruani shkurtimisht si është e rregulluar procedura e qasjes në hapësirat e juaja afariste (në objekte, hapësira prodhuese, depo, etj.), për personelin, vizitor, personat e tjerë, automjetet dhe mallin. b) Kush e kontrollon harmonizimin e procedurave të përcaktuara?
---------------	---

**Përgjigje:**

5.2.2.	<p>a) Përshkruani procedurat për rastin nëse personat/ automjetet e paautorizuara ndodhen në hapësirat afariste të firmës (në pronën tokësore apo në ndërtesa).</p> <p>b) Si i përfillen këto procedura personelit (p.sh. plani i veprimit, doracaku, udhëzimet për punë, trajnimi)?</p>
--------	--

**Përgjigje:**

5.2.3.	<p>Prezantoje një plan të lokacionit për çdo lokacion të kompanisë tuaj, që është i përfshirë në aktivitete doganore (p.sh.. plani, skica), në bazë e të cilave ata mund t'i përcaktojnë kufijtë, rrugët hyrëse dhe lokacionet e ndërtesave, nëse ka.</p>
--------	---

**Përgjigje:**

5.2.4.	<p>Specifikoni nëse është e aplikueshme, kompanitë (p.sh. kompanitë e huaja, pjesët e ndara të kompanisë), të cilat, po ashtu janë të vendosura në mjediset afariste të secilit lokacion.</p>
--------	---

**Përgjigje:**

5.3.	<b>Siguria fizike</b>
------	-----------------------

5.3.1.	<p>a) Përshkruani shkurtimisht se, si është i siguruar kufiri i jashtëm i hapësirës afariste të ndërmarrjes. Si verifikohet respektimi i këtyre procedurave?</p> <p>b) Si, kush dhe në çfarë intervalesh kohore i verifikon rrethojat dhe ndërtesat? Si regjistrohen këto verifikime dhe rezultatet e tyre?</p> <p>c) Si raportohet për incidentet e sigurisë dhe si zgjidhen ato?</p>
--------	--

**Përgjigje:**

5.3.2.	<p>Ju lutemi përgjigjuni në këto pyetje:</p> <p>a) Cilat mundësi për qasje ekzistojnë?</p> <p>b) Si zbatohen ato?</p> <p>A ka kufizime të orarit të punës në disa vende të qasjes?</p>
--------	--

**Përgjigje:**

5.3.3.	<p>A janë hapësirat afariste mjaftueshëm të ndriçuara (p.sh. dritë të vazhdueshme, sensorët e lëvizjes, çelësi për muzg)?</p>
--------	---

**Përgjigje:**

5.3.4.	<p>Si veprohet në firmën tuaj kur jepen çelësat (p.sh. vendi, e drejta në qasje, hyrja)?</p>
--------	--

	A ka dokumente me shkrim në lidhje me këtë? Po/Jo.
--	--

**Përgjigje:**

<b>5.3.5.</b>	<p>Ju lutemi përgjigjuni në këto pyetje:</p> <p>a) A është e lejuar parkimi i automjeteve private në hapësirat e juaja afariste?</p> <p>b) Nëse po, për cilët persona?</p> <p>c) Kush jep leje?</p> <p>d) A kontrollohen automjetet (në hyrje të hapësirave afariste apo në hyrje të vend parkimit)?</p> <p>A ka rregulla të shkruara? Po/Jo.</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.4.</b>	<b>Mjetet transportuese (sikurse kontejnerët, sëndukët e këmbëshëm, kutitë transportuese)</b>
-------------	---

<b>5.4.1.</b>	<p>A ka rregulla/ kufizime për qasje të mjeteve transportuese? Po/Jo.</p> <p>Nëse po, si zbatohet këto kufizime?</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.4.2.</b>	<p>Përshkruani shkurtimisht masat ekzistuese për evitimin e qasjes së paautorizuar dhe trajtimit të paautorizuar të mjeteve transportuese (veçanërisht në hapësirat e hapura të depove) (p.sh. mbikëqyrja e përhershme, trajnimi i personelit dhe njohja e personelit me rreziqet, plumbçet, udhëzimet dhe procedurat, që duhet t'i zbatojnë në rast të hyrjes së paautorizuar).</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.4.3.</b>	<p>a) A i përdorni plumbçet për evitimin e trajtimit të paautorizuar të mallit? Nëse i përdorni, çfarë janë ato?</p> <p>A i plotësojnë ato plumbçe normat e përcaktuara (p.sh. ISO)?</p> <p>b) Si e siguron mallin nga trajtimi i paautorizuar nëse nuk i përdorni plumbçet?</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.4.4.</b>	<p>Cilat masa të kontrollit i përdorni për kontrollin e mjeteve transportuese (p.sh. procedura e kontrollit në shtatë hapa: muri i përparmë, ana e majtë, ana e djathtë, fundi, kapaku/mbulesa, dyert e brendshme/të jashtme, pjesa e jashtme)?</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.4.5.</b>	<p>Ju lutemi përgjigjuni në këto pyetje:</p> <p>a) Kush është pronari/ operatori i mjeteve transportuese?</p> <p>b) Kush i mirëmban/ riparon mjetet transportuese?</p> <p>c) A ka plane për mirëmbajtje të rregullt?</p> <p>A verifikohen punët e jashtme të mirëmbajtjes ?</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.5.</b>	<b>Proceset logjistike</b>
-------------	----------------------------

<b>5.5.1.</b>	<p>a). Cilat mjetet të transportit zakonisht i përdor firma juaj?</p> <p>b). A i kryen firma juaj gjithë transportin e vet apo i shfrytëzon ofruesit e jashtëm të shërbimeve (p.sh. dërguesit/ transportuesit)?</p> <p>c). Si e përcaktoni nëse dërguesi/ transportuesi i përmbush normat e nevojshme të sigurisë (p.sh. nëpërmjet vërtetimit, deklaratës apo marrëveshjes për sigurinë)?</p> <p>d). A merrni masa të tjera për aktivitete të veçanta transportuese me qëllim të përmbushjes së normave të sigurisë?</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.6.</b>	<b>Kushtet jofiskale</b>
-------------	--------------------------

<b>5.6.1.</b>	<p>a) A merreni me mallrat me përdorim të dyfishtë dhe/ose mallrat, për të cilat kërkohet licenca për import apo malli, që është subjekt i kufizimeve të eksporteve ose embargove apo kërkesave të tjera jofiskale? Nëse po, përshkruani shkurtimisht se çfarë procedurash i përdorni për të siguruar pajtueshmërinë me dispozitat përkatëse në lidhje me këto mallra (p.sh. licencat e menaxhimit, autorizimet, përgjegjësitë e veçanta, të stafit të trajnuar posaçërisht, etj.).</p> <p>b) A ka referenca të veçanta për punë, doracakë apo udhëzime të tjera në firmën tuaj që ndërlidhen me këto mallra? Po/jo.</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.7.</b>	<b>Mallrat që arrijnë</b>
-------------	---------------------------

<b>5.7.1.</b>	<p>a) Përshkruani shkurtimisht procedurën për ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjen e mallrave që arrijnë.</p> <p>b) Përshkruani shkurtimisht si verifikohet respektimi i këtyre procedurave.</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

5.7.2.	A janë të punësuarit tuaj të njoftuar për masat e sigurisë të arritura me furnizuesit dhe si sigurohet respektimi i tyre?
--------	---

**Përgjigje:**

5.7.3.	<p>a) Përshkruani shkurtimisht si kryhet verifikimi i paprekshmërisë së plumbçeve për mallin që arrin.</p> <p>b) A i vendosen plumbçet mallit që arrin nëse është e nevojshme? Po/jo.</p> <p>c) A merret firma juaj me llojet e veçanta të mallrave për të cilat janë të nevojshme masat e veçanta të sigurisë (p.sh. ngarkesa ajrore/ posta ajrore)?</p> <p>Nëse po, cilat procedura/ masa të zakonshme janë në dispozicion?</p>
--------	---

**Përgjigje:**

5.7.4.	<p>A është paraparë që malli që arrin të emërtohet në mënyrë unike apo vendoset në hapësira të ndara? Po/jo.</p> <p>Nëse po, si emërtohet/ ku vendoset?</p>
--------	---

**Përgjigje:**

5.7.5.	Përshkruani shkurtimisht procedurën e numërimit dhe matjen e mallit në arritje.
--------	---

**Përgjigje:**

5.7.6.	Përshkruani shkurtimisht si, kur dhe kush e verifikon, nëse malli që arrin përputhet me dokumentet përcjellëse dhe shënoni në evidencën tuaj.
--------	---

**Përgjigje:**

5.7.7.	<p>a) A janë qartë të ndarë sektorët përgjegjës për blerjen e mallit, pranimin e mallit dhe menaxhimin e përgjithshëm të mallit? Po/jo.</p> <p>b) A ka mekanizma të integruar të kontrollit të brendshëm ndërmjet sektorëve? Po/jo. Nëse po, si zbatohen?</p>
--------	---

**Përgjigje:**

5.8.	<b>Ruajtja e mallit në depo</b>
------	---------------------------------

5.8.1.	Ju lutemi përshkruani, në cilat lokacione i keni ndarë hapësirat për ruajtjen e mallit.
--------	---

**Përgjigje:**



<b>5.8.2.</b>	<p>a) Ju lutemi, përshkruani shkurtimisht procedurën e zakonshme për renditjen e mallit që arrin në depo.</p> <p>b) A keni lokacione të depove të hapura? Po/Jo. Nëse po, ju lutemi përshkruani shkurtimisht ato.</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.8.3.</b>	<p>A keni procedura të dokumentuara për regjistrimin e mallit dhe zgjidhjen e parregullsive të zbuluara gjatë regjistrimit të mallit? Po/Jo.</p> <p>Nëse po, ju lutemi përshkruani shkurtimisht masat tuaja.</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.8.4.</b>	<p>A ruhen mallrat me shkallë të ndryshme të rrezikut ndaras? Po/Jo.</p> <p>a) Ju lutemi përshkruani kriteret për ruajtje ndaras (p.sh. mallrat e rrezikshme, mallrat me vlerë të madhe, kimikatet, armët, dërgesat ajrore/ posta ajrore).</p> <p>b) Ju lutemi përshkruani si siguroheni që malli menjëherë regjistrohet në evidencën e logjistikës/ evidenca e stoqeve.</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.8.5.</b>	<p>a) Përshkruani shkurtimisht si mbrohen mallrat nga qasja e paautorizuar në hapësirat e ruajtjes.</p> <p>b) Përshkruani shkurtimisht, si verifikohet respektimi i këtyre procedurave.</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.8.6.</b>	<p>Në qoftë se, vendosja e mallrave është veprimtari e ndarë te palët e treta ofruese të shërbimit, ju lutem përshkruani shkurtimisht se si dhe ku janë ruajtur mallrat dhe çfarë masash keni përdorur për të kontrolluar trajtimin e mallrave.</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.9.</b>	<b>Prodhimi i mallrave</b>
-------------	----------------------------

<b>5.9.1.</b>	<p>a) Përshkruani shkurtimisht, cilat lokacione/ hapësira janë të destinuara për prodhimin e mallrave?</p> <p>b) Nëse prodhimin e kryen bashkëpunëtori i jashtëm (p.sh. përpunimi, porositja nga furnizuesi direkt për konsumatorët e fundit (eng. Drop shipment), përshkruani shkurtimisht se si sigurohet identifikimi i mallit (p.sh., marrëveshjet kontraktuale).</p>
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.9.2.</b>	A ka masa të sigurisë me të cilat malli mbrohet nga qasja e paautorizuar në zonën e prodhimit? Po/jo. Nëse po, përshkruani shkurtimisht cilat janë ato masa dhe a janë në formë të shkruar. Përshkruani shkurtimisht si verifikohet respektimi i këtyre procedurave.
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.9.3.</b>	Përshkruani shkurtimisht procedurat e paketimit të prodhimeve dhe a ka në formë të shkruar.
---------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.9.4.</b>	Nëse paketimi i mallit të gatshëm si veprimtari e ndarë e kryen pala e tretë, përshkruani shkurtimisht si garantohet paprekshmëria e mallrave.
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.10.</b>	<b>Ngarkimi i mallrave</b>
--------------	----------------------------

<b>5.10.1.</b>	a) Përshkruani shkurtimisht si menaxhohet ngarkimi i mallrave në firmën tuaj (p.sh. ndarja e përgjegjësive, verifikimi i mallit dhe i mjeteve të transportit, regjistrimi i rezultatit, ofrimi i informatave, etj.)? b) A ka referenca me shkrim në lidhje me atë si duhet të organizohet procedura? Po/jo.
----------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.10.2.</b>	a) A u vendosen plumbçet mallit që del apo automjeteve? Po/jo? Nëse po, si, kush ua vë plumbçet dhe çfarë plumbçesh përdorni? b) A shënohen numrat e plumbçeve në dokumentet përcjellëse të mallit? Po/jo c) Si e mbani evidencën e plumbçeve tuaja?
----------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.10.3.</b>	Përshkruani shkurtimisht si garantohet respektimi i kërkesave të blerësit në aspektin e sigurisë së ngarkesës.
----------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.10.4.</b>	Përshkruajeni shkurtimisht masat me të cilat sigurohet, që malli i cili ngarkohet dhe procedura e ngarkimit të mos jenë pa mbikëqyrje.
----------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.10.5.</b>	A verifikohet paprekshmëria e mallit që dërgohet (p.sh. numërimi, matja)? Po/jo. Nëse po, si dhe kush i verifikon?
----------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.10.6.</b>	Përshkruani shkurtimisht si, kur dhe kush e verifikon, nëse malli që dërgohet është në përputhje me porositë dhe listat e mallit të ngarkuar dhe shlyerjen nga evidenca e stoqeve.
----------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.10.7.</b>	Përshkruani shkurtimisht mekanizmat tuaj të kontrollit për zbulimin e parregullsive që kanë të bëjnë me ngarkimin e mallit.
----------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.11.</b>	<b>Kushtet e sigurisë për partnerët afaristë</b>
--------------	--

<b>5.11.1.</b>	<p>a) Përshkruani shkurtimisht cilat janë kushtet në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes, kur i zbatoni para se ta zgjidhni partnerin afarist (p.sh. deklarata e sigurisë, kushtet e kontratës, partnerët tregtarë të cilët edhe vetë kanë statusin e OAE-së).</p> <p>b) Përshkruani shkurtimisht si verifikohet respektimi i këtyre procedurave.</p>
----------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.11.2.</b>	Përshkruani shkurtimisht, se si në firmën tuaj verifikohet identiteti i partnerit tregtar me qëllim të mbrojtjes së zinxhirit të furnizimit (kërkimi i informatave para pranimit të kërkesës apo porosisë).
----------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.11.3.</b>	<p>A keni vërejtur gjatë vitit të kaluar shkelje të marrëveshjeve të sigurisë me partnerët? Po/jo.</p> <p>Nëse po, cilat masa i keni marrë?</p>
----------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.12.</b>	<b>Siguria e të punësuarve</b>
--------------	--------------------------------

<b>5.12.1</b>	<p>a) Përshkruani shkurtimisht se si në kuadër të politikës suaj të punësimit zbatohen kërkesat në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes? Kush është përgjegjës për këtë lëmi?</p> <p>b) A janë bërë procedurat e sigurisë në formë të shkruar? Po/jo.</p> <p>c) Përshkruani shkurtimisht si verifikohet zbatimi i këtyre procedurave?</p>
---------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.12.2.</b>	<p>Në çfarë mase kategoritë e punëtorëve në vazhdim i nënshtrohen verifikimeve të sigurisë (p.sh. verifikimit nga policia që të vërtetohet se personi nuk është në evidencën e të dënuarve):</p> <p>a) Të punësuarit e rinj që do të punojnë në zonat e ndjeshme; dhe</p> <p>b) Të punësuarit aktualë që duhet të transferohen në zonat e ndjeshme të sigurisë.</p> <p>Si sigurohet që personi i cili largohet nga firma nuk ka më qasje fizike apo elektronike në hapësirat afariste apo në të dhënat e firmës?</p>
----------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.12.3.</b>	<p>A u sigurohet të punësuarve trajnimi në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes? Po/Jo. Nëse po:</p> <p>a) Sa shpesh trajnohen në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes?</p> <p>b) A ka ripërtëritje vjetore të njohurive? Po/Jo.</p> <p>c) A është ky trajnim interno apo i ofron kontraktori i jashtëm i shërbimeve?</p> <p>d) A ka evidencë me në lidhje me këto trajnime? Po/Jo.</p>
----------------	---

**Përgjigje:**

<b>5.12.4.</b>	<p>Ju lutem, përgjigjuni në këto pyetje:</p> <p>a) Specifikoni fushat në të cilat shfrytëzohen të punësuarit e përkohshëm.</p> <p>b) A verifikohen rregullisht të punësuarit sipas normave të sigurisë?</p> <p>Nëse po, kush dhe si i verifikon?</p> <p>A ka instruksione të sigurisë edhe për këta të punësuar?</p>
----------------	--

**Përgjigje:**

<b>5.13.</b>	<b>Shërbimet e jashtme</b>
--------------	----------------------------

**Përgjigje:**

<b>5.13.1.</b>	<p>A i shfrytëzoni "shërbimet e jashtme", në bazë të kontratës sikurse shërbimet e transportit, rojat, pastrimi, mirëmbajtja, etj.? Po/Jo. Nëse po:</p> <p>a) Përshkruani shkurtimisht cilat shërbime i ofrojnë ata dhe në çfarë mase (për ato që nuk janë përshkruar në kapitujt e mëparshëm).</p> <p>b) A ka marrëveshje me shkrim me ofruesit e jashtëm të shërbimeve që përmbajnë kërkesa të sigurisë? Po/Jo.</p> <p>c) Përshkruani shkurtimisht si verifikohet respektimi i procedurave të përfshira në ato marrëveshje.</p>
----------------	---